



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RREGULLORE  
PËR  
LICENCIMIN E RRJETEVE NUMERIKE DHE PROGRAMEVE TË TYRE, NËPËRMJET PROCEDURËS SË  
*BEAUTY CONTEST*

KREU I  
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për rrjetet numerike kombëtare sipas procedurës së *beauty contest*, në zbatim të nenit 139 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" që përcakton licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre që mbështeten në to në periudhën e tranzicionit.

Neni 2

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë rregullore do kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Beauty contest" procedurë përzgjedhje në të cilën pjesëmarrësit vlerësohen përmes krahasimit të performancës në fushën përkatëse.
2. "Palë e tretë" janë subjektet e licencuar për transmetime televizive dhe/ose audio analoge vendore sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 që aktualisht mbështeten në rrjete numerike.
3. "Udhëzuesi elektronik i programit" është mënyra elektronike e informimit të publikut lidhur me listën dhe orarin e programeve nga shërbimi i transmetimit, e cila është pjesë përbërëse e sistemit të transmetimit.
4. "Subjekte aplikues" janë shoqëritë që do të aplikojnë për marrjen e licencës për transmetime kombëtare audiovizive.
5. "Transmetim pa pagesë" është transmetimi, për marrjen e të cilit nuk i paguhet tarifë subjektit që e siguron këtë shërbim.
6. "Akses i kushtëzuar" është çdo masë dhe/ose rregullim teknik që mundëson marrjen në formë të kuptueshme të shërbimeve të mbrojtura, kundrejt një autorizimi individual paraprak. Aksesit i kushtëzuar është një shërbim ndërmjetës që realizon abonimin në shërbimet televizive. Ai mund të kërkohej edhe nga shërbimet pa pagesë (free-to-air).
7. "Pajisje e ndaluar" është çdo pajisje ose program i projektuar ose i përshtatur për dhënien e aksesit në një shërbim të mbrojtur në një formë të kuptueshme, të qartë, pa autorizimin e ofruesit të shërbimit.
8. "Shërbim programi televiziv" është tërësia e programeve brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv.
9. "Shërbimi i programit audio" është shërbimi i programit audio i licencuar si operator radio analog që mbështetet në një rrjet ekzistues numerik të palicencuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

10. "Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)" është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.

11. "Program/transmetim i hapur" është program i cili transmetohet pa pagesë për publikun.

### Neni 3

#### Baza Ligjore

Licencimi sipas procedurës së *beauty contest* mbështetet në aktet e mëposhtme ligjore:

1. Ligji nr. 9851 datë 26.12.2007 "Për ratifikimin e akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencës 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06) dhe të akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për rishikimin e marrëveshjes së Stokholmit, 1961 (RRC-06 REV. ST 61), të zhvilluar në Gjenevë, 15 maj - 16 qershor 2006.
2. Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë",
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 "Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike".
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 466 datë 27.02.2013 "Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave".

### Neni 4

1. Në procesin e licencimit sipas *beauty contest*, ftohen të marrin pjesë operatorët privatë historikë kombëtarë si dhe operatorët ekzistues, me eksperiencë në transmetimet numerike ku përfshihen subjekte që operojnë njëkohësisht si operatorë rrjeti dhe programi.
2. Numri i licencave të transmetimeve numerike private kombëtare që i nënshtrohet rregullimit sipas *beauty contest*-it, është 5 (pesë).
3. Programet analoge kombëtare private të licencuara sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, do të transmetohen hapur edhe pasi të mbështeten në platformat numerike.
4. Në një rrjet numerik kombëtar, jo më pak se 10% të kapacitetit të rrjetit (programe të veta dhe të të tretëve) do të përdoret për të mbështetur programet e hapura.

### Neni 5

#### Karakteristikat e rrjeteve private numerike kombëtare, struktura e shërbimeve të programeve që mbështeten në to, subjekt i procedurës së licencimit sipas *beauty contest*

1. Rrjetet private numerike kombëtare, subjekt i procedurës së licencimit sipas *beauty contest* kanë karakteristikat e mëposhtme:

Gjerësia e bandës	8 MHz
Brezi i frekuencave	470-790 MHz
Teknologjia	DVB-T2
Sistemi i Kodimit	MPEG-4
Cilësia e transmetimit	SD/HD

Afati për kalimin nga teknologjia DVB-T/MPEG-2 në DVB-T2/MPEG-4 është jo më vonë se 3 vjet nga data e dhënies së licencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

2. Struktura e shërbimeve të programeve që do të mbështeten në rrjetet kombëtare private numerike ka përbërjen e mëposhtme:

Tab 1

	KARAKTERI I PROGRAMIT	PROGRAME TE VETA
1	I Përgjithshëm	Të paktën 1 program
2	Informativ	Të paktën 1 program
3	Fëmijë	Të paktën 1 program
4	Rini	Të paktën 1 program
5	Shkencë	Të paktën 1 program
6	Sport	Të paktën 1 program
7	Filma	Të paktën 1 program
8	Produksione shqip	Të paktën 1 program
9	Muzikë	Të paktën 1 program

- Subjektet aplikues që ofrojnë shërbime programore të tematizuara sport duhet të mbështetin në rrjetin kombëtar numerik të paktën 4 nga kategoritë e programeve të përshkruara në tabelën e mësipërme.
- Subjekti aplikues është i detyruar që të paktën 60% të programeve të veta audiovizive t'a transmetojë në gjuhën shqipe: të jenë të prodhuara në gjuhën shqipe ose përmes titrimit të programeve të huaja në gjuhën shqipe ose përshkrimit të tyre me zë në gjuhën shqipe.
- Përveç programeve të mësipërme, aplikuesit kanë të drejtë të mbështetin në rrjetin numerik edhe programet e veta të mëposhtme:

Tab 2

	KARAKTERI I PROGRAMIT
1	Program për të rritur
2	Program Reality Shoë
3	Program Mode
4.	Program on demand
5	Program promocial
6.	Lifestyle
7.	Programe të tjera

**Neni 6**  
**Shfrytëzimi i rrjeteve**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1. Subjekti i cili do të licencohet për transmetime numerike kombëtare audiovizive, ka të drejtë të shfrytëzojë deri në 60 për qind të kapacitetit transmetues të rrjetit numerik për mbështetjen e programeve të veta.
2. Subjekti që do të licencohet për transmetime numerike kombëtare audiovizive është i detyruar t'i japë akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të rrjetit numerik të tyre, OSHMA-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe/ose licencë shërbimi programi audioviziv.
3. Mbajtësit e licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të. Çdo kontratë e lidhur midis mbajtësit të licencës kombëtare numerike të transmetimit audioviziv dhe OSHMA-ve duhet të depozitohet në AMA brenda 30 ditësh nga data e nënshkrimit. Tarifat për dhënien e aksesit për transmetim në rrjetin numerik duhet të orientohen në kosto.
4. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.
5. Në rast mosmarrëveshjes midis OSHMA-ve dhe mbajtësve të licencave kombëtare të transmetimeve numerike audiovizive, palët i drejtohen AMA-s.

**KREU II**  
**PROCEDURA E LICENCIMIT**

**Neni 7**  
**Objekti**

1. Objekti i procedurës së licencimit sipas *beauty contest* është:
  - 1.1. Dhënia e 5 licencave kombëtare transmetimi audioviziv të përbëra nga:
    - a) Licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe
    - b) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, për ndërtimin e vënien në funksionim të 5 rrjeteve numerike tokësore kombëtarë në brezat e frekuencave 470-790 MHz me gjerëzi brezi 8 MHz, në teknologjinë DVBT-2, me standartin e kompresionit MPEG-4.

**Neni 8**  
**Procedura e *beauty contest***

1. AMA, me vendim, përcakton subjektet që do të marrin pjesë në procedurën *beauty contest*, duke i ftuar të aplikojnë për marrjen e një licence kombëtare të transmetimit audioviziv të përbërë nga:
  - a) Licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe
  - b) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, për ndërtimin e vënien në funksionim të 5 rrjeteve numerike tokësore kombëtarë në brezat e frekuencave 470-790 MHz me gjerësi brezi 8 MHz, në teknologjinë DVBT-2, me standartin e kompresionit MPEG-4.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

2. Kryetari i AMA-s ngre Komisionin e Beauty Contestit, të kryesuar nga Zëvendëskryetari ose nga një nëpunës i autorizuar nga Kryetari i AMA-s dhe përbëhet nga 1(një) përfaqësues i çdo drejtorie të administratës së AMA-s.
3. Komisioni i Beauty Contestit, shqyrton aplikimet e subjekteve që do të marrin pjesë në procedurën *beauty contest*.
4. AMA miraton dokumentacionin e licencimit sipas *beauty contest*-it për secilin nga 5 rrjetet numerike tokësore kombëtare.
5. AMA fton publikisht subjektet që plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në procedurën *beauty contest*, për dhënien e licencave kombëtare të transmetimit audioviziv.
6. Aplikimet për licencë bëhen brenda 40 ditëve nga marrja e ftesës.
7. Aplikimet duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimit të kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.

#### Neni 9

##### **Njoftimi i procedurës së licencimit sipas *beauty contest***

Njoftimi për organizimin e procedurës së *beauty contest*-it publikohet në faqen zyrtare të AMA-s, në të paktën 3 gazeta të përditshme me tirazhin më të lartë, në Radiotelevizionin Publik dhe televizionet private kombëtare për të paktën 3 ditë rradhazi.

#### Neni 10

##### **Kushtet e pjesëmarrjes në procedurën e *beauty contest***

1. Ftesa për pjesëmarrje në *beauty contest*-it jep informacion për procedurën, qëllimin e saj dhe dokumentacionin e aplikimit.
2. Subjekti i ftuar nga AMA, për të marrë pjesë në procedurën *beauty contest*, duhet të plotësojë këto kushte:
  - a. të shlyejë detyrimet financiare ndaj AMA-s dhe buxhetit të shtetit;
  - b. të tërheqë kundrejt pagesës dokumentacionin e miratuar për këtë procedurë;
  - b. të paraqesë aplikimin në vendin, kohën dhe formën e specifikuar në ftesën për pjesëmarrje në procedurën e *beauty contest*;
  - c. të përcaktojë adresën e saktë për korrespondencë zyrtare.
3. Në ftesën për pjesëmarrje në *beauty contest* do të përcaktohet vendi dhe afati përfundimtar për tërheqjen e dokumentacionit.

#### Neni 11

##### **Tërheqja e dokumentacionit të *beauty contest*-it**

1. Për të siguruar transparencë, trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin e subjekteve në përdorimin e frekuencave si burim natyror i kufizuar, dokumentacioni i licencimit të procedurës së *beauty contest* do të tërhiqet nga aplikuesit me short.
2. Në ftesën për pjesëmarrje në *beauty contest* do të përcaktohet vendi, data dhe ora e tërheqjes së dokumentacionit përmes shortit.
3. Procedura e shortit zhvillohet para Komisionit të Beauty Contest.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

4. Mosparaqitja e subjektit për tërheqjen e dokumentacionit në vendin, datën dhe orën e përcaktuar, sjell skualifikimin e tij nga procedura e licencimit. Në këtë rast, AMA organizon konkurrimin e hapur në përputhje me kreun VII dhe VIII të ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

**Neni 12**

**Sqarimet mbi dokumentacionin e *beauty contest***

1. Jo më vonë se 20 ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimit, subjektet e që kanë blerë dokumentacionin e licencimit mund të kërkojnë sqarime me shkrim nga AMA, për dokumentacionin e *beauty contest*.

2. Sqarimet e bëra nga AMA mbi dokumentacionin e *beauty contest*, pavarësisht kërkesës së një ose më shumë subjekteve, do t'u njoftohen të gjithë subjekteve që kanë blerë dokumentacionin e *beauty contest* dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

**Neni 13**

**Aplikimi**

1. Aplikimi duhet të përgatitet në përputhje me kërkesat e publikuara në dokumentacionin e *beauty contest*.
2. Aplikimi do të paraqitet sipas modelit të miratuar nga AMA, pjesë e dokumentacionit të *beauty contest*. Dokumentacioni që përmban zarfi dhe që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se një muaj para datës së aplikimit.
3. Aplikanti plotëson vetëm hapësirat e modelit të përcaktuara për t'u plotësuar me të dhëna. Subjekti aplikues nuk duhet të bëjë asnjë ndryshim në përmbajtjen e modelit të miratuar.
4. Subjekti aplikues, do të paraqesë dokumentacionin e aplikimit duke plotësuar kërkesat ligjore, financiare, programore dhe teknike të përcaktuara në këtë rregullore.
5. Aplikimi duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.
6. Dokumentacioni i aplikimit nuk i kthehet aplikuesit.

**KREU III**

**PROCEDURA E SHQYRTIMIT DHE VENDIMMARRJES**

**Neni 14**

**Përmbajtja e aplikimit**

Aplikimi duhet të përmbajë dokumentacionin e përcaktuar në Formularin e Aplikimit, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

**Neni 15**

**Kërkesa të përgjithshme**

1. Licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepet shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, me objekt veprimtarinë audiovizive. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri aksionare janë nominative. Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë aksionare që aplikon për licencë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

2. Licenca kombëtare e transmetimit audioviziv nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.

#### Neni 16

##### Kërkesat financiare

1. Licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepet subjekteve që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në vlerën jo më pak 3.500.000 lekë.
2. Subjekti aplikues duhet të paraqesë garanci bankare në masën 15.800.000 lekë. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar për një periudhë prej 24 muajsh, duke filluar ky afat nga data e depozitimit të aplikimit.
  - 2.1 Garancia bankare ç'ngurtësohet para afatit 24 mujor në rast se:
    - a. Subjekti ka dalë në transmetim dhe ka kryer pagesën vjetore për licencë;
    - b. Subjektit i është refuzuar aplikimi për licencë për transmetim kombëtar audioviziv.
  - 2.2. Në rast se subjekti nuk ka dalë në transmetim dhe është debitor ndaj AMA-s, garancia bankare kalon në llogari të AMA-s në masën e detyrimit, pjesa e mbetur çngurtësohet menjëherë.

#### Neni 17

##### Kërkesat programore

1. Aplikuesit për licencë kombëtare të transmetimit audioviziv për programet e veta duhet të garantojnë, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, se në përmbajtjen e programeve të tyre do të përmbushin standardet programore duke:
  1. Nxitur vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit;
  2. Respektuar paanshmërinë, plotësinë e pluralizmin e informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin për formim të lirë të opinionëve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme asnjë grupimi politik, ekonomik, komuniteti a organizate fetare apo çdo grupi tjetër interes;
  3. Respektuar mirëkuptimin dhe bashkëzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
  4. Respektuar fqinjësinë dhe marrëdhëniet e mira mes popujve;
  5. Promovuar kulturën kombëtare shqiptare dhe gjuhën shqipe;
  6. Promovuar kulturën europiane, të mbajë në konsideratë nevojën e formimit të opinionit publik për t'u njohur dhe për të kuptuar vlerat dhe traditat europiane;
  7. Ofruar mundësi për promovim të krijuesve të rinj në fushën e muzikës, të shfaqjeve teatrore dhe sidomos ato të lidhura me kulturën kombëtare;
  8. Ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në territorin e RSH-së për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave;
  9. Respektuar dinjitetin, të drejtat themelore të njeriut dhe privatësinë;
  10. Shmangur mesazhet e drejtpërdrejta ose të nënkuptuara diskriminuese për shkaqe të bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjinie, race, ngjyre, etnie, gjuhe, orientimi seksual, të gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, apo për çdo shkak tjetër;
  11. Ruajtur sekretin e burimeve të informacionit.

#### Neni 18

##### Kërkesat teknike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1. Aplikuesit për licencë kombëtare të transmetimit audioviziv duhet të paraqesin aplikimin në përputhje me kërkesat teknike, ku bëjnë pjesë:

- a. Plani i frekuencave të rrjetit numerik kombëtar, të miratuar nga AMA bazuar në Aktet Finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve "Për planifikimin e transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06)", ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 9851 datë 26.12.2007;
- b. Standardet e transmetimit;
- c. Pikat e transmetimit dhe fuqitë përkatëse të rrezatuara që përcaktojnë zonën e mbulimit;
- ç. Shërbimet shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to;
- d. Teknologjia e transmetimit;
- dh. Afati i liritimit të frekuencave të zëna arbitrarisht;
- e. Afati i përfundimit të ndërtimit të rrjetit.

### Neni 19

#### Dokumentacioni i aplikimit

1. Aplikuesit për licencë kombëtare të transmetimit audioviziv që do t'i nënshtrohen procedurës së *beauty contest*, duhet të plotësojnë kërkesat për kualifikim si më poshtë:

1.1 Të dhënat e aplikuesit:

- a. Regjistrimi në QKR me gjithë ndryshime (nëse ka), forma ligjore, emërtimi i subjektit, lista e aksionerëve me kuotat respektive;
- b. Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik duhet të paraqesë listën e ortakëve të tij;
- c. Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionerëve të subjektit;
- ç. Adresa, nr. tel, fax, e\_d. mail;
- d. Personi përfaqësues.

1.2 Kërkesa teknike:

- a. Objekti dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, si dhe projekti teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave;
- b. Projekti dhe preventivi i rrjetit, konform planit kombëtar të frekuencave, hartuar nga një subjekt i pajisur me licencë profesionale; (a. skema e organizimit, b. projektet teknike të studiove; c. projektin teknik të pikave të transmetimit, d. karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese);
- c. Projekti dhe preventivi i rrjetit, i shërbimeve fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP, hartuar nga një subjekt i pajisur me licencë profesionale;
- d. Cilësia e transmetimit për të gjithë programet që mbështeten në rrjet;
- e. Afati i propozuar për lirim të frekuencave të zëna arbitrarisht, nëse operojnë në kushte të tilla duke migruar në frekuencat e përcaktuara në Planin Numerik (GE 06) sipas specifikimeve të AMA-s, i cili nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj nga data e dhënies së licencës. Ky afat mund të ndryshojë me propozim dhe vendimmarrje të përbashkët të AMA-s dhe Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike;
- f. Afati i propozuar për kalimin në DVB-T2 dhe MPEG-4;
- g. Kapaciteti i transmetimit i lënë në dispozicion të të tretëve;
- h. Propozimet për aplikimin e shërbimeve të reja;

1.3 Kërkesat ekonomike:

- a. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pasqyruar dhe i depozituar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- b. Biznes plani me treguesit e tij dhe analizat përkatëse për periudhën e vlefshmërisë së licencës; (a. përshkrimi i shoqërisë, b. analiza e tregut, c. strategjia e marketingut, d. burimet e financimit dhe objektivat financiare);
- c. Garancia bankare.
- d. Lista e administratorëve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, burimet dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca.
- e. Bilanci financiar i depozituar në zyrën e tatimeve për 3 vitet e fundit.

1.4 Kërkesat programore:

- a. Përmbajtja e programeve që do të transmetohen dhe struktura programore e propozuar për transmetim, të cilat të shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë e informacionit;
- b. Të dhëna statistikore për programet audiovizive të katalogut të shërbimit programor të përgjithshëm dhe të tematizuar (informacion, kulturë, art, argëtim, zbavitje, ekranizime, sport, emisione për fëmijë, reklamë, etj.)
- c. Të dhëna për kohëzgjatjen e programeve;
- d. Struktura programore;
- dh. Përshkrimi i përmbajtjes së programeve kryesore të prodhuara vetë;
- e. Informacion mbi përqindjen e kohës së parashikuar për transmetimin e veprave evropiane.
- f. Depozitimi i marrëveshjeve të lidhura me mbajtësit e të drejtave të programeve që do të transmetohen.

1.5 Të tjera:

- a. Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe/ose Drejtoria e Tatimeve mbi numrin e punonjësve të siguruar të aplikuesit si dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjektit për 12 muajt e fundit nga paraqitja e aplikimit;
  - b. Deklaratë noteriale mbi interesat financiare në subjekte që ushtrojnë veprimtari audio dhe/ose audiovizive;
  - c. Deklarata për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura;
  - ç. Informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionerëve të saj;
  - d. Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë, lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit Drejtues (të paktën 9 anëtarë), përgjegjës për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv. Jo më pak se pesë prej anëtarëve të Bordit Drejtues duhet të kenë eksperiencë në fusha të tilla si media e komunikim, inxhinieri, financë ose si aktivistë të shoqërisë civile.
2. Aplikanti duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.
  3. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.

## Neni 20

### Shqyrtimi i aplikimeve

Komisioni i Beauty Contest shqyrton dhe verifikon të dhënat e paraqitura nga subjektet dhe përmbushjen e kriterëve ligjore ekonomike, teknike programore etj. Anëtarët e Komisionit të Beauty Contest, sipas kompetencës, përgatitin relacionet e vlerësimit. Komisioni i Beauty Contest përgatit relacionin përmbledhës dhe ia përcjell AMA-s për vendimmarrje.

AMA në rast se konstaton mangësi në respektimin e procedurave të shqyrtimit të dokumentacionit, pjesë e aplikimit, ka të drejtë të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.

Anëtarët e Komisionit të Beauty Contest mbajnë përgjegjësi për saktësinë e përpunimit të të dhënave të akteve të sipërcituara si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve me të cilat njihet gjatë këtij procesi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Informacionet në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve nuk duhet t'u bëhen të njohura aplikuesve a personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.

### Neni 21

#### Vendimi për dhënien e licencave

1. Vendimi për dhënien ose mosdhënien e licencës së transmetimit audioviziv kombëtar jepet nga AMA jo më vonë se 60 ditë nga dita e aplikimit.
2. Kur AMA vendos mosmiratimin e aplikimit, duhet të njoftojë aplikuesit për:
  - a) arsyet e vendimit;
  - b) rezultatin e vlerësimit të aplikuesit;
  - c) rezultatin e aplikimit fitues.
3. Kundër vendimit të AMA-s, aplikuesi mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".
4. I licencuari për transmetim audioviziv kombëtar i nënshtrohet të gjitha kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
5. Në rast se në përfundim të procesit të licencimit sipas procedurës *beauty contest* rezulton se mbeten të palicencuara rrjete numerike dhe kapacitete të lira në to, AMA brenda 30 ditëve, organizon konkurrimin e hapur në përputhje me kreun VII dhe VIII të ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
6. Subjekti, të cilit i është refuzuar aplikimi për licencë për transmetim kombëtar audioviziv, që ushtron veprimtari të palicencuar në transmetimet numerike audio dhe/ose audiovizive, është i detyruar që brenda 30 ditëve nga data e dhënies së vendimit të AMA-s, të ndërpresë transmetimet audio dhe/ose audiovizive.

### Neni 22

#### Autorizimi për shërbimin e aksesit të kushtëzuar

1. Subjekti, i cili do të pajiset me licencë për transmetim audioviziv kombëtar autorizohet për ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar për programet e veta dhe të të tretëve që mbështeten në rrjetin e tij.

Ofrimi i shërbimit të aksesit të kushtëzuar të të tretëve programi i të cilëve mbështetet në rrjetin e licencuar, bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit përkatëse.
2. I autorizuari për shërbimin e aksesit të kushtëzuar nuk lejohet t'u ofrojë shërbimin e aksesit të kushtëzuar subjekteve të palicencuar/autorizuar nga AMA.
3. Ofrimi i shërbimit të aksesit të kushtëzuar kryhet në përputhje me kushtet dhe kriteret e rregullores së miratuar nga AMA, për shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

### Neni 23

#### Shërbimet pa pagesë (free-to-air)

I licencuari për transmetim audioviziv kombëtar siguron që të gjithë dekoderët që ofron vetë në shitje të kenë aftësinë të marrin dhe shfaqin transmetimet e hapura (free-to-air) të të gjithë rrjeteve numerike kombëtare, rajonale dhe lokale në një zonë të caktuar. Udhëzuesi elektronik i programeve i inkorporuar në këta dekoderë siguron që shërbimet e hapura të shfaqen në ekran dhe të zgjidhen nga shikuesit pa i detyruar ata të paguajnë ndonjë tarifë. Informacionet që shfaqen në Udhëzuesin Elektronik të Programeve duhet të jenë në gjuhën shqipe.

### Neni 24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**Afati i licencës**

Licenca kombëtare numerike e transmetimit audioviziv jepet për një afat 15 vjeçar.

**Neni 25**

**Detyrimi për daljen në transmetim dhe mbulimi**

1. I licencuari për transmetim audioviziv kombëtar sipas procedurës *beauty contest* është i detyruar që brenda 6 muajve nga data e licencimit të mbulojë me sinjal qarqet e Tiranës dhe të Durrësit dhe brenda 12 muajve nga data e licencimit të mbulojë me sinjal jo më pak se 50% të territorit të vendit.
2. Afatet për daljen në transmetim, do të përcaktohen në licencë, në përputhje me planin e implementimit të ishujve digjitalë të parashikuar në strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

**Neni 26**

**Detyrimet financiare**

1. Pagesat për marrjen e licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audioviziv kombëtar dhe autorizimit për shërbimin e aksesit të kushtëzuar për licencën për transmetim audioviziv kombëtar, do të kryhen bazuar në vendimin nr. 04, datë 22.05.2013 të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
2. Pagesa vjetore për licencë kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamat vonese në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.

**Neni 27**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të AMA-s.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

ANEKSI 1  
FORMULAR APLIKIMI

PËR MARRJEN E LICENCËS KOMBËTARE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV SIPAS PROCEDURËS SË  
*BEAUTY CONTEST*

Seksioni 1 Përfaqësimi

Emri i subjektit	
Adresa postare	
Telefon	
Fax	
Email	

Bazuar në ftesën për pjesëmarrje në procedurën e *beauty contest* për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv, miratuar nga AMA me vendimin nr. 29, datë 16.04.2015 më poshtë, në emër të shoqërisë \_\_\_\_\_sh.a., paraqes aplikimin e plotësuar për marrjen e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv, të përbërë nga:

- Licenca të shërbimit të programeve audiovizive të veta;
- Licencë për ndërtimin e operimin e një rrjeti numerik tokësore kombëtar në brezat e frekuencave 470-790 MHz me gjerësi brezi 8 MHz, në teknologjinë DVBT-2, me standartin e kompresionit MPEG-4.

Deklaroj se njoh dhe pranoj kërkesat e nenit 139 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, mbi licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to, dhe kërkesat e rregullores “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës *beauty contest*, miratuar me vendimin 28, datë 16.04.2015 të AMA-s.

Në emër të shoqërisë \_\_\_\_\_sh.a., paraqes dokumentacionin e mëposhtëm:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

## I. Kërkesat ligjore

Tabela nr. 1

Nr.	Dokumentacioni i kërkuar	Po/Jo
1.	Ekstrakti i thjeshtë dhe historik për të dhënat e subjektit (Bashkëlidhur)	
2.	Ekstrakti i thjeshtë dhe historik i personit juridik nëse njëri nga ortakët e shoqërisë aplikuese është person juridik (Nëse aplikohet bashkëlidhur)	
3.	Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionerëve të subjektit (Bashkëlidhur)	
4.	Adresa, nr. tel, fax, mail (Bashkëlidhur)	
5.	Personi përfaqësues (Bashkëlidhur akti i përfaqësimit nëse aplikohet)	

## II. Kërkesat teknike

Tabela nr. 2

Nr.	Dokumentacioni i kërkuar	Po/Jo
1.	Objekti dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, projekti teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave (Bashkëlidhur)	
2.	Projekti dhe preventivi i rrjetit, hartuar nga një subjekt i pajisur me licencë profesionale (Bashkëlidhur dokumentacioni)	
3.	Projekti dhe preventivi i rrjetit, të shërbimeve fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP, hartuar nga një subjekt i pajisur me licencë profesionale (Bashkëlidhur dokumentacioni)	
4.	Cilësia e transmetimit për programet e veta që mbështeten në rrjet (Bashkëlidhur informacioni mbi programet HD dhe SD që parashikohet të mbështeten në rrjet, plotëso tabelën nr. 2.1)	
5.	Afati i propozuar për lirim të frekuencave e frekuencave të zëna arbitrarisht, nëse operojnë në kushte të tilla dhe migrimi në frekuencat e përcaktuara në Planin Numerik (GE 06) sipas specifikimeve të AMA-s, i cili nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj nga data e dhënies së licencës. Ky afat mund të ndryshojë me propozim dhe vendimmarrje të përbashkët të AMA-s dhe	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

	Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike;	
6.	Afati i propozuar për kalimin në DVB-T2 dhe MPEG-4	
7.	Kapaciteti i transmetimit që parashikohet t'u lihet në dispozicion të tretëve (Plotëso tabelën nr. 2.1 dhe nr. 2.2)	
8.	Propozimet për aplikimin e shërbimeve të reja (Informacioni bashkëlidhur)	

Kapaciteti i transmetimit i lënë në dispozicion të të tretëve dhe cilësia e transmetimit për programet e veta, duke respektuar specifikimet teknike të miratuara nga AMA.

Tabela Nr. 2.1

Shfrytëzimi i kapacitetit të rrjetit numerik	Nr	Mbps
Programet audiovizive të veta		
Programet audiovizive të të tretëve		
Programet audio të veta		
Programet të veta me akses të kushtëzuar		
Programet e veta (SD)		
Programet e veta (HD)		
Totali		

Data e fillimit të ofrimit të kapaciteteve për të tretët

Tabela Nr. 2.2

Brenda tre muajve pas marrjes së licencës	
Brenda gjashtë muajve pas marrjes së licencës	
Mbi gjashtë muaj pas marrjes së licencës por jo më vonë se 9 muaj	

### III. Kërkesat ekonomike

Tabela Nr. 3

Nr.	Dokumentacioni i kërkuar	Po/jo
1.	Kapitali i shoqërisë, pasqyruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Bashkëlidhur dokumentacioni)	
2.	Biznes plani me treguesit e tij dhe analizat	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

	përkatëse për periudhën e vlefshmërisë së licencës (Bashkëlidhur, plotëso tabelat Nr. 3.1 dhe Nr. 3.2)	
3.	Garancia bankare (Bashkëlidhur)	
4.	Lista e administratorëve (Bashkëlidhur informacioni)	
5.	Parashikimi për shpenzimet dhe të ardhurat, burimet dhe shumën e financimit për kohëzgjatjen e licencës	
6.	Bilanci financiar i shoqërisë për 3 vitet e fundit	

*Fuqia ekonomike që rezulton nga kapitali themeltar i aplikantit*

Tabela Nr. 3.1

	<i>Mijë lekë</i>
Kapitali i trupëzuar	
Likuiditete të ngurtësuara	

*Plani për të ardhurat e shpenzimet gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës*

Tabela Nr 3.2

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Vitet e vlefshmerisë		
			5 vjeçari I	5 vjeçari II	5 vjeçari III
	<b>I. Të ardhurat</b>				
a.	Të ardhura nga kontratat dhe shërbimet për të tretët	000/lekë			
b.	Të ardhura nga sponsorizime, financime etj.	000/lekë			
c.	Të ardhura nga shitja e dekodeve	000/lekë			
d.	Të ardhurat nga reklamat	000/lekë			
dh.	Të ardhura nga abonentët	000/lekë			
e.	Të ardhura të tjera	000/lekë			
	<b>Totali i të ardhurave</b>	000/lekë			
	<b>II . Shpenzime</b>				
	<b>1. Shpenzime materiale e të</b>				



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

	<b>tjera</b>				
a.	Shpenzime për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit	000/lekë			
b.	Shpenzime për përpunimin teknik të programeve	000/lekë			
c.	Shpenzime për energji elektrike, karburant, ngrohje	000/lekë			
d.	Shpenzime për qera	000/lekë			
e.	Shpenzime për taksa e tatime direkte e indirekte	000/lekë			
	<b>Shuma</b>	<b>000/lekë</b>			
	<b>2. Shpenzime për paga e sigurime shoqërore</b>				
a.	Fond page për të punësuar me kohë të plotë	000/lekë			
b.	Fond page për të punësuar me honorare	000/lekë			
	<b>Shuma</b>	000/lekë			
	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>000/lekë</b>			
	<b>Fitimi bruto</b>	<b>000/lekë</b>			
	<b>III. Punonjës gjithsej</b>	nr.			
a.	Stafi krijues	nr.			
b.	Stafi inxhiniero-teknik	nr.			
c.	Administrata	nr.			
	<b>IV. Investimet</b>				
a.	Investime për pajisje të reja	000/lekë			
b.	Investime për rinovim teknologjie	000/lekë			
c.	Investime për kualifikimin e punonjësve	000/lekë			
	<b>Shuma</b>	000/lekë			
	<b>Burimi i Financimit:</b>				
a.	Fitimi i realizuar dhe i akumuluar	000/lekë			
b.	Kontributi i ortakëve	000/lekë			
c.	Hua nga të tretë	000/lekë			
	<b>Shuma</b>	000/lekë			

Shënim: Aplikuesi duhet të paraqesë planin e të ardhurave e shpenzimeve për të gjithë vitet e licencimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**Çmimi i ofruar për mbështetjen e të tretëve në rrjet**

Tabela Nr. 3.3

Pagesa e përcaktuar për mbështetjen e OSHMA-ve të tretë në rrjetin numerik.

- Pagesa për program audioviziv SD \_\_\_\_\_ lekë
- Pagesa për program audioviziv HD \_\_\_\_\_ lekë
- Pagesa për program audio \_\_\_\_\_ lekë
- Pagesa për ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar \_\_\_\_\_ lekë

**Çmimet për përdoruesit e shërbimeve audiovizive:**

- 1. Çmimet e shitjes së dekoderit bazë \_\_\_\_\_ lekë
- 2. Çmimet e paketave programore:
  - 2.1. \_\_\_\_\_
  - 2.2. \_\_\_\_\_
  - 2.3. \_\_\_\_\_
  - 2.4. \_\_\_\_\_
  - 2.n. \_\_\_\_\_

**III. Kërkesat mbi programet**

- 3. Ofrimi i programeve audiovizive duke respektuar të drejtën për informacion dhe pluralizëm, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut, sidomos për mbrojtjen e të miturve etj., përmbajtja e të cilave duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit, si më poshtë:

**3.1. Promovimi i punëve të pavarura.**

3.1.1. Përqindja e kohës së transmetimit që do të rezervohet për promovimin e punëve të pavarura.

\_\_\_\_\_

3.1.2. Përqindja e shpenzimeve të parashikuara për punë shqiptare dhe evropiane, të krijuara nga prodhues që janë të pavarur nga transmetuesit në buxhetin e subjektit aplikues.

\_\_\_\_\_

3.2. Përqindja e kohës së transmetimit që do të rezervohet për veprat evropiane, (duke përjashtuar në programin e përgjithshëm, kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojërat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe të shitjeve të drejtpërdrejta në televizion).

\_\_\_\_\_

**3.3. Përdorimi i gjuhës së shenjave**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

3.3.1 Përqindja e kohës së transmetimit me përdorimin e gjuhës së shenjave në raport me kohën e përgjithshme të transmetimit.

\_\_\_\_\_

3.3.2. Përqindja e programeve ku do të përdoret gjuha e shenjave në raport me numrin e përgjithshëm të programeve.

\_\_\_\_\_

3.4. Shërbimet e teletekstit që do të ofrohen.

\_\_\_\_\_

3.5 Alternativat e transmetimit të programeve në gjuhë të huaj:

3.5.1 Përqindja e programeve që do të transmetohen të titruara dhe dubluara me mundësi zgjedhje nga përdoruesit.

3.5.2 Përqindja e programeve që do të transmetohen vetëm të titruara.

\_\_\_\_\_

3.5.3 Përqindja e programeve që do të transmetohen vetëm të dubluara.

\_\_\_\_\_

3.6. Struktura programore e propozuar për shërbimin e programit të përgjithshëm

Program i përgjithshëm	Orë transmetimi ne javë	Vepra audiovizive europiane (orë transmetimi javore)	Përqindje në raport me kohën totale të transmetimit javor
Programe informative			
Programe për fëmijë			
Programe edukative			
Programe të aktualitetit			
Filma			
Programe argëtuese			
Programe sportive			

3.7. Paraqitja e masave të propozuara për të siguruar mbrojtjen e të miturve në rast transmetimi të programeve pornografike.

3.8. Shërbimet e mbrojtura

Të dhënat mbi sistemin e aksesit të kushtëzuar përfshirë udhëzuesin elektronik të programeve.

3.8.1. \_\_\_\_\_

3.8.2. \_\_\_\_\_

3.8.3. \_\_\_\_\_

3.8.4. \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

IV. Kërkesa të tjera

Tabela nr. 1

Nr.	Dokumentacioni i kërkuar	Po/Jo
1.	Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe/ose Drejtoria e Tatimeve mbi numrin e punonjësve si dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjektit për periudhën 12 muaj nga paraqitja e aplikimit (Bashkëlidhur dokumentacioni)	
2.	Deklaratë noteriale mbi interesat financiare në subjekte që ushtrojnë veprimtari audio dhe/audiovizive (Nëse aplikohet, bashkëlidhur)	
3.	Deklaratë mbi vërtetësinë e të dhënave të paraqitura (Bashkëlidhur)	
4.	Informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionerëve të saj (Bashkëlidhur)	
5.	Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë, lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit Drejtues (të paktën 9 anëtarë), përgjegjës për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv. Jo më pak se pesë prej anëtarëve të Bordit Drejtues duhet të kenë eksperiencë në fusha të tilla si media e komunikim, inxhinieri, financë ose si aktivistë të shoqërisë civile	